



Information zur Verabreichung von Medikamenten in Kinderbildungs- und -betreuungseinrichtungen

Informacion lidhur me dhënien e medikamenteve në institucionet e arsimimit dhe përkujdesjes së fëmijëve

Mënyra e procedimit

Shumë shpesh prindërit, gjegjësisht, kujdestarët ligjorë, i drejtohen stafit të institucioneve për arsimim dhe përkujdesje të fëmijëve me kërkesën, që fëmijëve të tyre në kopsht (foshnjore, strehë ditore etj.) t' u jepen medikamentet e përshkruara nga mjeket/mjekët.

Çështja e dhënies së medikamenteve fëmijëve është përgjegjësi e kujdestarëve ligjorë (prindërve) si dhe e mjekëve/mjekeve, gjegjësisht e personelit shëndetësor.

Në bazë të ligjit, personeli i institucionit për arsimim dhe përkujdesje të fëmijëve, parimisht nuk është i autorizuar të japë medikamente. Nga kjo del edhe më e qartë se ky personel **në asnjë mënyrë nuk obligohet për këtë.**

Megjithatë, në raste përjashtuese është e pamundur përkujdesja ndaj fëmijëve nëse nuk bëhet dhënia e medikamenteve të domosdoshme nga stafi edukues. Në këto raste, **stafi edukues, me vetiniciativë, mund të deklarohej i gatshëm** që të marrë përsipër dhënien e medikamenteve të domosdoshme gjatë orarit të punës së institucionit për arsimim dhe përkujdesje fëmijësh. Mirëpo, ashtu siç u theksua më parë, kjo gjë nuk është obligative. Pra, prindërit nuk mund të kërkojnë dhënien e medikamenteve.

Sidoqoftë, dhënia e medikamenteve duhet bërë vetëm në marrëveshje /dakordim të qartë me kujdestarin/en ligjor/e, si dhe sipas udhëzimeve strikte mjekësore.

Gjithashtu duhet cekur edhe § 27 i Ligjit për Arsimim dhe Përkujdesje të Fëmijëve i Shtajermarkut, sipas të cilit, pranimi i një fëmije në institucion mund të kushtëzohet edhe nga fakti se a ka fëmija një atest mjekësor, sipas të cilit mund të vijojë institucionin për arsimim dhe përkujdesje të fëmijëve.